



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: Mbrojtje e Bimëve

Programi: Mbrojtje e Bimëve- Fitomedicinë

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Vjosana Rraci, me titull: **“PËRHAPJA E TRIPSIT TË QEPËS (*Thrips tabaci*) NË SPEC DHE LAKËR DHE MASAT PËR MENAXHIMIN E TYRE”** ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 06/12/2023 deri me datë 12/12/2023.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Dr. Arben Mehmeti, kryetar,
2. Prof. Asoc. Dr. Fadil Musa, mentor - anëtar,
3. Prof. Dr. Skender Kaçiu, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Ptof. Asoc. Dr. Fadil Musa, përmes e-mail adresës fadil.musa@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraparak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është mund të jetë një pasurim i punës tonë !

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI MBROJTJE E BIMËVE



PUNIMI I TEMËS SË DIPLOMËS PËR STUDIMET MASTER

**PËRHAPJA E TRIPSIT TË QEPËS (*Thrips tabaci*) NË SPEC DHE
LAKËR DHE MASAT PËR MENAXHIMIN E TYRE**

Udhëheqës:

Prof. Asoc. Dr. Fadil Musa

Kandidatja:

Bsc. Vjosana Rraci

Prishtinë, Nëntor 2023

ABSTRAKT

Speci (*Capsicum annum*) dhe lakra (*Brassica oleracea*) janë dy prej kulturave perimore të rëndësishme në vendin tonë, ku zënë një vend të rëndësishëm në ekonominë agrare të vendit. Këto dy bimë janë të ndryshme për nga familjet *Solanaceae* (për specin) dhe *Brassicaceae* (për lakrën), por të dyja kanë aftësi të mira për të u përshtatur me kushtet e ndryshme agroekologjike. Kultivimi i këtyre kulturave ka një rëndësi të jashtëzakonshme për prodhimin e ushqimit dhe për ekonominë në vend. Ata dallohen nga kulturat e tjera perimore për shkak të një numri të madh të kultivarëve dhe hibrideve të disponueshëm.

Disa nga kultivarët më të njohur të specit që kultivohen më shumë në vendin tonë dhe kanë treguar rezultate të mira në prodhim janë: Somborka, Duga Bella, Kaverxhiku, Kosovka

Në anën tjetër, lakrat (*Brassica oleracea*) gjithashtu kanë disa kultivarë të njohur dhe të preferuar në vendin tonë, duke përfshirë: Partula, Proktori, Atria, Bravo, etj. Këto dy kultura, gjatë tërë fazave të tyre të zhvillimit, janë të prekura nga një gamë e gjerë e dëmtuesve të ndryshëm të bimëve, të cilët shpesh shkaktojnë dëme serioze.

Si pasojë e prekjës nga ky dëmtues rendimenti i lakrës dhe i specit shpesh herë zvoglohet në masë të konsiderueshme sidomos kur intensiteti i shfaqjes së dëmtuesit është i lartë dhe nëse nuk ndërmerren masa mbrojtëse për menaxhimin e tij. Qëllimi i këtij punimi ka qenë: *(i)* Hulumtimi i përhapjes së tripsit të qepës (*Thrips tabaci*) te speci dhe lakra e kultivuar në fushë të hapur në fshatin Sfeqël të komunës së Podujevës, *(ii)* Përshkrimi i ciklit jetësorë të tripsit të qepës si dëmtues polifag i kulturave bujqësore *(iii)* Përcaktimi i ndjeshmërisë së specit dhe lakrës ndaj prekjës nga tripsi i qepës, *(iv)* Përcaktimi i dinamikës dhe nivelit të populacionit të tripsit të qepës te speci dhe lakra, si dhe *(v)* Masat për menaxhimin e dëmtuesit. Për nevojat e hulumtimit të këtij dëmtuesi, hulumtimet janë realizuar gjatë vitit 2023, në fshatin Sfeqë, Komuna e Podujevës në lakër dhe spec të kultivuar në fushë të hapur. Në eksperiment janë përfshirë tre kultivarë të lakrës dhe tre të specit të cilët kultivohen në masë të madhe në vendi tonë, ndërkaq eksperimenti është realizuar sipas metodës së blloqeve të randomizuara në tri përsëritje. Në secilën përsëritje sipas metodës së rastit janë kontrolluar nga disa bimë të lakrës dhe specit prej të cilave gjatë tërë periudhës së hulumtimit në intervale prej 15 ditësh janë mbledhur tripsat insektet prezente. Mostrat e marra nga tereni janë sjellur

në laboratorin e Mbrojtjes së Bimëve, në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë për identifikimin e tyre. Për identifikimin e tripsit të qepës (*Thrips tabaci*) janë përdorur çelësa dhe atlase të ndryshme entomologjike, ndërsa përpunimi statistikor i rezultateve është bërë përmes programit IBM SPSS Statistics.

Gjatë këtyre hulumtimeve është konstatuar se lakra preket më shumë nga ky dëmtues në raport me specin. Gjithashtu, edhe në mes të kultivarëve si të lakra edhe të speci janë konstatuar dallime statistikore sinjifikante. Rezultatet dhe të dhënat të cilat janë arritur gjatë këtyre hulumtimeve kanë rëndësi shkencore dhe praktike sepse për herë të parë kemi të dhëna mbi përhapjen dhe prekjen e lakrës dhe specit si kultura perimore nga ky dëmtues dhe ndjeshmërinë që kanë kultivarët e lakrës dhe të specit ndaj këtij dëmtuesi në aspektin praktik ku edhe fermerët me kohë dhe në mënyrë profesionale do të njoftohen për rrezikshmërinë e infestimit si dhe mënyrat më të mira të mbrojtjes së këtyre dy kulturave nga tripsi i qepës.